



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 163

Tiranë – E Enjte, 23 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

	Page
Ligj nr. 127/2014 datë 2.10.2014	Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë 8249
Ligj nr. 128/2014 datë 2.10.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9150, datë 30.10.2003, “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë” 8253
Ligj nr. 129/2014 datë 2.10.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar 8255
Ligj nr. 130/2014 datë 2.10.2014	Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, të ndryshuar 8267
Ligj nr. 131/2014 datë 2.10.2014	Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar 8267
Ligj nr. 132/2014 datë 2.10.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër “Horizon 2020 - Programi për kërkim dhe inovacion” 8268
Ligj nr. 133/2014 datë 2.10.2014	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin në lidhje me një amendament të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar (neni 3 bis), të nënshkruar në Montreal më 10 maj 1984 8275
Vendim i Kuvendit nr. 76/2014, datë 16.10.2014	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar 8278
Dekret nr. 8756 datë 21.10.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 8278
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 667, datë 8.10.2014	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatët e tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND 8278

Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Financave nr. 14, datë 9.10.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 11.4.2014 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimit rural” të ndryshuar	8279
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 15, datë 20.10.2014	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 12, datë 15.7.2014 “Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t’u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”	8280
Urdhër i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Kulturës nr. 8499, datë 17.10.2014	Për përcaktimin e disa rregullave të qarkullimit rrugor në Ansamblin Monument Kulture të aksit kryesor dhe Qendrën Historike të Qytetit të Tiranës	8281



LIGJ
Nr. 127/2014

PËR URDHRIN E STOMATOLOGUT
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet juridike dhe etiko - profesionale të profesioneve, stomatologë dhe ndihmësstomatologë, si dhe organizimin e Urdhrit të Stomatologut.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë stomatologët dhe ndihmësstomatologët që e ushtrojnë këtë profesion në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Statusi

Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është ent publik, jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesionistëve, stomatologë dhe ndihmësstomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.

KREU II
MISIONI DHE BUXHETI

Neni 4
Misioni

1. Misioni i Urdhrit të Stomatologëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve në fushën e stomatologjisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të stomatologut.

2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Stomatologëve ushtron këto kompetenca:

a) jep dhe heq licencën individuale të ushtrimit të profesionit;

b) vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo stomatolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;

c) rivlerëson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit të Stomatologëve përballë standardeve të vendosura;

ç) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional dhe etik të anëtarëve të Urdhrit;

d) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, institucione të tjera shkencore dhe arsimore për të siguruar standarde të larta në Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;

dh) krijon dhe mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit, i cili është i ndarë në pjesë të veçanta për stomatologët dhe ndihmësstomatologët dhe menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij;

e) mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit të stomatologut.

Neni 5
Kriteret e anëtarësisë

1. Janë anëtarë të Urdhrit të Stomatologut të gjithë stomatologët që ushtrojnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e stomatologut, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë brenda apo jashtë shtetit, i njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale;

ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim që do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik.

2. Stomatologut, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion shëndetësor, ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, i duhet edhe:

a) leja e qëndrimit dhe leja e punës në Republikën e Shqipërisë;



b) certifikata e mirësjelljes (*Good Standing Certificate*) nga urdhri/dhoma apo shoqata e stomatologëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka masa ndëshkimore;

c) njësimi (konvalidimi) i diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj;

ç) rekomandimi nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Stomatologut;

d) njohja e gjuhës shqipe, e vërtetuar me dëshmi nga një autoritet i licencuar nga shteti. Stomatologu jorezident detyrimisht duhet të punojë me përkthyes.

3. Procedura e anëtarësimit dhe ndërprerjes së anëtarësisë përcaktohet në statutin e Urdhrit të Stomatologut, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar.

4. Ndhimësstomatologët regjistrohen në një regjistër të veçantë të Urdhrit.

Ndhimësstomatologu për t'u regjistruar në Urdhriin e Stomatologut duhet të plotësojë këto kritere:

a) të ketë një diplomë për ndihmësstomatolog, të njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin.

b) në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.

c) të njohë dhe të zotohet me shkrim që do të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.

Procedura e regjistrimit të ndihmësstomatologëve në urdhër përcaktohet në statutin e Urdhrit të Stomatologut.

5. Urdhri, me akte të veçanta, përcakton mënyrën e regjistrimit të anëtarëve, të evidentimit e të mirëmbajtjes së regjistrave, përmbajtjen e tyre dhe formën e shkresave, vërtetimeve e akteve të tjera, si dhe vulën e Urdhrit, në bazë të evidencës zyrtare.

Neni 6

Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e stomatologut dhe të ndihmësstomatologut në sistemin e kujdesit shëndetësor, publik apo privat, në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Stomatologut dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.

2. Anëtar i Urdhrit ka këto detyrime:

a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e shëndetësisë, Statutin e Urdhrit të Stomatologut dhe Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.

b) të punojë pa ndërprerje për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit në vazhdim mjekësor.

c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifën e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.

Neni 7

Bashkëpunimi

1. Urdhri i Stomatologut, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë e institucionet në varësi të saj dhe me ministrinë, institucionet qendrore dhe organizmat të tjerë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, publikë ose jopublikë.

2. Urdhri i Stomatologut bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë.

3. Urdhri i Stomatologut informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhriin e Stomatologut për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.

Neni 8

Buxheti

1. Urdhri i Stomatologut ka buxhetin e tij, të cilin e miraton Asambleja Kombëtare dhe e administron vetë në përputhje me rregullat financiare në fuqi. Burimet financiare të Urdhrit të Stomatologut janë:

a) kuotizacionet e anëtarëve;

b) tarifën e regjistrimit dhe të dhënies së të drejtës individuale për ushtrimin e profesionit,



vërtetime dhe dokumente të tjera, për të cilat urdhri mban evidencë zyrtare;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

2. Të ardhurat e siguruara sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i Stomatologëve i përdor për të përmbushur misionin e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.

KREU III ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 9

Organet kryesore

1. Organet kryesore të Urdhrit të Stomatologut janë:

- a) asambltetë;
- b) këshillat;
- c) komisionet disiplinore;
- ç) presidentët e Urdhrit.

2. Zgjedhjet në organet e sipërpërmendura duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Neni 10

Asambltetë

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e këshillave rajonale.

2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:

- a) Presidenti i Këshillit Kombëtar;
- b) kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të Asamblesë.

3. Asambleja rajonale zgjedh këshillin rajonal.

4. Përbërja e anëtarëve të asambltesë rajonale dhe procedurat e zgjedhjes së tyre përcaktohen në Statutin e Urdhrit të Stomatologëve.

Neni 11

Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar përbëhet nga 25 anëtarë, ndër të cilët 20 janë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare dhe 5 të tjerët janë: Presidenti i Urdhrit të Stomatologëve, zëvendësi i tij, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, një përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, të

caktuar nga presidenti i Urdhrit në bazë të kriterëve të përcaktuara në statutin e Urdhrit.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

a) miraton strukturën e vet organizative dhe të këshillave rajonalë;

b) zgjedh Presidentin e Urdhrit të Stomatologëve dhe zëvendësin e tij;

c) cakton kuotizacionin dhe tarifat;

ç) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar, duke përcaktuar fondet në administrimin e këshillave rajonalë;

d) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;

dh) mbikëqyr dhe ndërhyt në rregullimin e marrëdhënieve të punës të stomatologëve me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

e) miraton statutin, rregulloret e Urdhrit si dhe Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik.

Neni 12

Këshilli rajonal

1. Këshilli rajonal përbëhet nga 5 deri në 9 anëtarë, në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Stomatologëve në qark. Anëtarët e këshillit propozohen dhe zgjidhen nga asambleja rajonale.

2. Rregullat e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave rajonalë përcaktohen në statutin e Urdhrit.

3. Këshilli rajonal ka këto funksione:

a) mbikëqyr dhe ndërhyt në rregullimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet stomatologëve dhe ndihmësstomatologëve në sektorin publik dhe privat në qark;

b) administron buxhetin dhe të gjitha pasuritë e Urdhrit në nivel qarku;

c) cakton komisionin disiplinor në nivel qarku.

4. Zgjedhjet për Këshillin Rajonal bëhen çdo 5 vjet.

Neni 13

Presidentët e Urdhrit

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative, të cilat propozohen nga Asambleja Kombëtare.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Stomatologut me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtë rrizgjedhjeje vetëm njëherë.



3. Këshillat rajonale zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonale. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Stomatologut duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;

c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;

ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;

d) të kenë kryer botime shkencore në fushën e stomatologjisë;

dh) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

5. Funksioni i presidentëve të Urdhrit të Stomatologut është i papajtuësëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.

6. Presidentët e Urdhrit e përfundojnë mandatin e tyre përpara kohe në këto raste:

a) shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit Kombëtar ose këshillit rajonal, me jo më pak se dy të tretat e anëtarëve;

b) japin dorëheqjen;

c) dënohen me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) humbasin zotësinë e plotë për të vepruar;

d) bëhen të paafte për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tyre, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.

7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e presidentëve të Urdhrit të Stomatologut përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

Neni 14

Komisionet disiplinore

1. Pranë këshillave rajonale dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë komisionet disiplinore, si organizma të gjykimit profesional. Komisioni disiplinor rajonal përbëhet nga 7 anëtarë të zgjedhur nga këshilli rajonal. Komisioni Disiplinor Kombëtar përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

2. Mënyra e ngritjes dhe e funksionimit të komisioneve disiplinore përcaktohet në statutin e Urdhrit.

3. Komisioni verifikon dhe shqyrton ankesat e çdo personi për shkelje të Kodit Etik Deontologjik Stomatologjik, si dhe për gabime profesionale të anëtarëve të Urdhrit të Stomatologut.

4. Komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonale, ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

Neni 15

Masat disiplinore

1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe seancës dëgjimore. Kur nuk kemi të bëjmë me një vepër penale dhe vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit Etik Deontologjik Stomatologjik ose ka bërë gabime teknike, komisioni jep këto masa:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore, publike dhe private;

d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut deri në 3 vjet;

dh) përjashtim nga Urdhri i Stomatologut për një periudhë deri në 3 vjet;

2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve, si masë plotësuese, kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite.

3. Masat e sipërpërmendura disiplinore mund të shlyhen në qoftë se, brenda 1 viti nga dita e dhënies së tyre për shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, dhe brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

4. Gjoha e vendosur sipas shkronjës “c”, të pikës 1, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 16

Ankimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i



këshillit rajonal paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

2. Komisioni disiplinor, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 17 **Organizimi i zgjedhjeve të para**

Ministri përgjegjës për shëndetësinë ngarkohet të ngrejë një komision të përkohshëm, detyra e të cilit është të organizojë zgjedhjet e para të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet automatikisht.

Neni 18 **Transferimi i të dhënave**

Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Urdhri i Mjekëve detyrohet të transferojë të gjithë informacionin që disponon, lidhur me stomatologët dhe ndihmësstomatologët e regjistruar pranë Urdhrit të Mjekëve, tek Urdhri i Stomatologut.

Neni 19 **Financimi fillestar**

Urdhri i Stomatologut subvencionohet nga shteti për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar që nga momenti i zgjedhjes së Këshillit Kombëtar të Urdhrit.

Neni 20 **Shfuqizimi**

1. Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, stomatologët do të anëtarësohen në Urdhri e Mjekëve, deri në momentin e zgjedhjes së Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut.

Neni 21 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8745, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ Nr. 128/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9150, DATË 30.10.2003, “PËR URDHRIN E FARMACISTËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9150, datë 30.10.2003, “Për Urdhri e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1, pika 2, fjalët “Urdhri i Farmacistëve është ent publik” zëvendësohen me fjalët “Urdhri i Farmacistëve është ent publik jobuxhetor”.

Neni 2

Në nenin 3, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Urdhri i Farmacistëve garanton që anëtarët e Urdhrit përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit të vendosur nga institucioni përkatës.”.

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

1. Urdhri i Farmacistëve, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme, nëpërmjet përfaqësimit ndërinstitucional, me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, me institucionet e saj



vartëse si dhe me ministritë e tjera, me institucionet qendrore dhe organizma të tjerë publikë ose jopublikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Farmacistëve informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrit e Farmacistëve për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën farmaceutike.”

Neni 4

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1. Shkronja “ç” e pikës 1 shfuqizohet.

2. Pas shkronjës “ç”, të pikës 1, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Presidentët e Urdhrit.”

3. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Zgjedhjet në organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri””.

Neni 5

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Presidentët e Urdhrit

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Farmacistëve me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.

3. Këshillat rajonale zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonale. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Farmacistëve duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;

c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;

ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;

d) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

5. Funkzioni i presidentëve të Urdhrit të Farmacistëve është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.”

Neni 6

Në nenin 10, pika 2, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Kombëtar bëhen çdo 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.”

b) Fjalja e pestë ndryshohet si më poshtë:

“Zgjedhjet në këshillin rajonal bëhen çdo 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.”

Neni 7

Në nenin 11, pika 2, bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, fjalët “mandat 4-vjeçar” zëvendësohen me fjalët “mandat 5-vjeçar”.

2. Fjalja e dytë shfuqizohet.

Neni 8

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

1. Këshilli rajonal krijohet në bazë qarku dhe përbëhet nga 5 deri 9 anëtarë në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit, në qark.

2. Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësin e vet.

3. Këshilli rajonal emëron dhe shkarkon sekretarin.”

Neni 9

Në nenin 17, pika 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Gjobat e vjela sipas shkronjës “c”, të pikës “1”, të këtij neni, derdhen njëqind për qind në Buxhetin e Shtetit.”



Neni 10

Në nenet 10, 11 dhe 16 emërtimi “Asambleja e Përgjithshme” zëvendësohet me emërtimin “Asambleja Kombëtare”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8746, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ**Nr. 129/2014**

**PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9901,
DATË 14.4.2008, “PËR TREGTARËT DHE
SHOQËRITË TREGTARE”,
TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

Direktivën 2009/109/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të datës 16 shtator 2009, që ndryshon direktivat e Këshillit 77/91/KEE, 78/885/KEE, 82/891/KEE dhe direktivën 2005/56/KE, lidhur me kërkesat për raportim dhe dokumentim në rastet e bashkimeve dhe ndarjeve, e ndryshuar. nr. Celex: 32009 L0109, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 259, datë 2.10.2009, faqe 14–21.

Direktivën 2009/101/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 shtator 2009, mbi koordinimin e masave, të cilat për qëllime të mbrojtjes së interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta, duhet të zbatohen nga shoqëritë e shteteve anëtare, në kuptimin e paragrafit të dytë, të nenit 48, të traktatit, dhe me qëllim për t'i bërë këto masa ekuivalente, e ndryshuar. nr. Celex: 32009L0101, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.258, datë 1.10.2009, faqe 11–19.

“Neni 3/1

Shkaqet e pavlefshmërisë

1. Shkaqet të pavlefshmërisë së themelimit të një shoqërie tregtare, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (në vazhdim QKR), janë:

a) dokumentacioni për regjistrimin fillestar të shoqërisë, sipas nenit 28, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, nuk është hartuar në formë shkresore;

b) mungesa e zotësisë juridike për të vepruar e të gjithë themeluesve të shoqërisë;

c) objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në kundërshtim me ligjin;

ç) në statutin e shoqërisë nuk përcaktohen emri i shoqërisë, vlera e kontributeve të nënshkruara nga secili themelues, vlera e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar nga të gjithë themeluesit, apo statuti nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë;

d) vlera e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë, nënshkruar nga të gjithë themeluesit, është më e ulët se vlera e kapitalit minimal, të kërkuar për shoqërinë tregtare, sipas parashikimeve të këtij ligji;

dh) kapitali i nënshkruar i shoqërive aksionare nuk është shlyer nga themeluesit përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në mënyrat dhe në masën e kërkuar nga ky ligj.

2. Shkaqet e pavlefshmërisë, të parashikuara në pikën 1, janë të vetmet shkaqet, të cilat sjellin pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë, pas regjistrimit të saj në QKR.

3. Pavlefshmëria absolute, parashikuar në një nga shkaqet e pikës 1, konstatohet nga gjykata dhe sjell për pasojë prishjen e shoqërisë tregtare dhe hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas parashikimeve të nenit 190, pika 1, ose të nenit 192, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

4. Pavlefshmëria relative, e parashikuar në një nga shkaqet e pikës 1, shpallet nga gjykata. Shpallja e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor, të



përmendur në pikën 3, të këtij neni, rrethana që shkakton pavlefshmërinë është korrigjuar, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Gjykata që shqyrton padinë e ngritur në lidhje me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare, gjatë të njëjtit proces gjyqësor, vlerëson nëse rrethana, që shkakton pavlefshmërinë, është korrigjuar dhe publikuar sipas kërkesave të pikës 4 të këtij neni.

6. Pavlefshmëria e shoqërisë tregtare, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk mund t’u kundrejtohet palëve të treta që kanë fituar të drejta nga shoqëria pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe nuk çliron themeluesit e shoqërisë nga detyrimi për të paguar kontributet e nënshkuara prej tyre, të paktën deri në vlerën e nevojshme për të përballuar detyrimet e marra përsipër ndaj kreditorëve.

7. Padia për të kërkuar që shoqëria tregtare të shpallet e pavlefshme parashkruhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në çdo rast, padia e lidhur me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare nuk mund të ngrihet pas publikimit të korrigjimit të rrethanës që shkakton pavlefshmërinë, sipas këtij neni, nëse kjo rrethanë mund të korrigohet.”

Neni 2

Në nenin 11, pika 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.”

Neni 3

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Kompetencat e organeve të shoqërisë dhe përfaqësimi ligjor”.

2. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Statuti apo vendimet e shoqërisë nuk mund të ndryshojnë apo të kufizojnë kompetencat që ky ligj përcakton për organet e ndryshme të shoqërisë tregtare. Çdo veprim, që ka për qëllim ndryshimin apo kufizimin e kompetencave të organeve të shoqërisë, të cilat

nuk lejohen shprehimisht, sipas këtij ligji, nuk mund t’u kundrejtohen palëve të treta edhe nëse janë bërë publike në statut apo sipas mënyrave të parashikuara nga ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

2. Shoqëritë tregtare përfaqësohen në marrëdhëniet me të tretët nga përfaqësuesit e tyre ligjorë, të cilët veprojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky ligj dhe nga dispozitat e statutit. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon kufizime në tagrin e përfaqësuesit ligjor për të vepruar i vetëm për disa apo për të gjitha marrëdhëniet e shoqërisë me të tretët. Përfaqësuesit ligjorë mbeten të detyruar ndaj shoqërisë për të zbatuar të gjitha kufizimet e tagrave të përfaqësimit në marrëdhëniet me të tretët, të përcaktuara në statut apo të miratuara nga organet e shoqërisë. Me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për kufizimin e tagrit të përfaqësuesit ligjor për të vepruar i vetëm për disa apo për të gjitha marrëdhëniet e shoqërisë me të tretët apo në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të, ky kufizim i tagrave të përfaqësimit mund t’u kundrejtohet palëve të treta vetëm nëse është bërë publik në mënyrat e parashikuara nga ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.”

Neni 4

Në nenin 13, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Këshilli i administrimit ose këshilli mbikëqyrës i shoqërisë aksionare, që ka dhënë miratimin e një veprimi, sipas pikave 2 e 3, të këtij neni, duhet që pa vonesa, por në çdo rast brenda 72 orëve, t’i njoftojë asamblesë së përgjithshme aktin e miratimit të këtij veprimi, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e interesit të personave të përfshirë. Në rastin e shoqërive aksionare me ofertë publike, ky njoftim duhet të publikohet brenda afatit të sipërpërmendur edhe në faqen e internetit të shoqërisë, pavarësisht nga detyrimet e tjera për publikimin e miratimit të dhënë, që këto shoqëri mund të kenë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”. Brenda 6 muajve nga data e kryerjes së njoftimit për dhënie e



autorizimit, sipas pikave 2 e 3, të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës të shpallë veprimin juridik të miratuar si të pavlefshëm, nëse miratimi është dhënë në shkelje të rëndë të ligjit apo të statutit.”.

Neni 5

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë

1. Individit, i cili gëzon cilësinë e ortakut, aksionarit apo përfaqësuesit të ortakut ose aksionarit, të administratorit apo të anëtarit të këshillit të administrimit të shoqërisë tregtare, i cili, me veprimet apo mos veprimet e tij, i siguron vetes apo të tretëve një përfitim ekonomik të padrejtë, apo i shkakton një të treti pakësimin e pasurisë me dashje, është përgjegjës personalisht ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike, me pasurinë e tij, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë kur:

a) ka abuzuar me formën dhe/ose përgjegjësinë e kufizuar që ofron shoqëria tregtare; ose

b) ka trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose

c) në çastin kur ka marrë dijëni apo duhet të kishte marrë dijëni që shoqëria nuk ka kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet ndaj palëve të treta, nuk mori masat e nevojshme, të përfshira në kompetencat e tij/të saj, sipas këtij ligji, për të mos lejuar që, në varësi të rrethanave, shoqëria të vazhdonte ushtrimin e veprimtarisë tregtare, dhe/ose marrjen përsipër të detyrimeve të reja ndaj palëve të treta, përfshirë autoritetet publike.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përgjegjësia personale për detyrimet e shoqërisë kufizohet deri në vlerat e përcaktuara në vijim:

a) në rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë; ose

b) në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, për detyrimet e papaguara të shoqërisë, deri në vlerën e tregut të pasurisë apo pasurive të shoqërisë tregtare, të cilat i ka trajtuar si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose

c) në rastin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, deri në vlerën e përgjithshme

të detyrimeve të papaguara të shoqërisë, të cilat kanë lindur pas marrjes dijëni për gjendjen e parashikuar sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Nëse një apo më shumë nga shkeljet e sipërpërmendura kryhen së bashku nga më shumë se një prej personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, atëherë këta persona përgjigjen në mënyrë solidare ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike.

4. Personi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, mban përgjegjësi personale ndaj palëve të treta, përfshi autoritetet publike, vetëm nëse kryerja e shkeljeve të përcaktuara në këtë nen vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Personi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, nuk mban përgjegjësi personale ndaj palëve të treta, të cilat, në momentin e marrjes përsipër të detyrimit nga shoqëria, kishin dijëni për shkeljet e përcaktuara në këtë nen apo, në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishin dijëni për to.

6. Padia ndaj personave të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga data e kryerjes së shkeljes.”.

Neni 6

Në nenin 24, në fjalinë e dytë, fjalët “nenet 25 deri në 36” zëvendësohen me fjalët “nenet 25 deri në 37”.

Neni 7

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

1. Shoqëria kolektive prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;

b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe që tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;



d) në rastet e parashikuara sipas nenit 47, të këtij ligji;

dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

ë) me vendim të ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga shumica e ortakëve, ndërsa në rastin e parashikuar sipas shkronjës “ë”, të pikës 1, të këtij neni, është i nevojshëm një vendim unanim i ortakëve.

3. Në rast mosveprimi të ortakëve për të vendosur prishjen e shoqërisë, për rastet e parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, në çdo kohë, për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë prej shkaqeve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe korrigjimi është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë, si pasojë e rasteve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.”

Neni 8

Në nenin 68, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

2. Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.”

Neni 9

Në nenin 71, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.”

Neni 10

Në nenin 73, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.”

Neni 11

Në nenin 77 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të këtij ligji, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një



marrëveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.”.

Neni 12

Në nenin 85, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.”.

Neni 13

Në nenin 88, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të këtij ligji.”

Neni 14

Në nenin 92, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, neni 87, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë drejtpërdrejt, përpara gjykatës kompetente, padi në emër të shoqërisë, për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e

përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve të përcaktuar më sipër vlerësohet e refuzuar.”.

Neni 15

Në nenin 95 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:

“Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji.”.

2. Pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

“7. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

8. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

9. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.”.

Neni 16

Neni 99 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 99

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;

b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;



c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;

d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të këtij ligji.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkakun i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij

neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.”.

Neni 17

Në nenin 112, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Raporti i vlerësimit, i përmendur në paragrafët e mësipërm, nuk është i detyrueshëm në rastet vijuese:

a) shoqëria themelohet në vijim të një bashkimi apo ndarjeje dhe raporti i vlerësimit të ekspertëve, të përcaktuar sipas nenit 217, të këtij ligji, është hartuar;

b) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, dhe nëse raporti i vlerësimit të ekspertëve të përcaktuar sipas nenit 217, të këtij ligji, është hartuar;

c) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadrin e një oferte për marrje në kontroll, me objekt blerjen apo shkëmbimin e aksioneve, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërisë, e cila është objekt i ofertës publike për marrje në kontroll.”.

Neni 18

Në nenin 113, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Aksionet e nënshkruara me kontribut në natyrë duhet të paguhen tërësisht përpara regjistrimit, nëpërmjet kalimit në favor të shoqërisë të titullit të pronësisë së kontributit në natyrë. Nëse, sipas ligjit, kërkohet kryerja e formaliteteve të posaçme për regjistrimin e kalimit të titullit të pronësisë së kontributit në natyrë, këto formalitete kryhen nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë. Kontributi në natyrë do të konsiderohet i paguar në çastin kur aksionari të ketë kryer të gjitha veprimet dhe të ketë nënshkruar të gjitha aktet e kërkuara nga ligji për kalimin e titullit të pronësisë së kontributit në emër të shoqërisë.”.

Neni 19

Në nenin 114, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Nëse shoqëria mbetet me një aksionar, atëherë aksionari i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të



Regjistrimit”, të ndryshuar. Nëse aksionari i mbetur nuk e përmbush këtë detyrim, atëherë aksionari përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data, në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.”.

Neni 20

Në nenin 117, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet e kalimit të aksioneve me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionin, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshi momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e aksionit hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Transaksionet në formë elektronike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”, konsiderohen të kryera në formë shkresore në përputhje me parashikimet e këtij neni. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit a publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.”.

Neni 21

Në nenin 133, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Aksionet e një shoqërie që zotërohen nga një shoqëri tjetër, e cila, në momentin e fitimit të tyre, nuk ishte, por bëhet në vijim shoqëri e kontrolluar, duhet që, në mënyrë alternative, të shiten nga shoqëria e kontrolluar apo të anulohen nga shoqëria mëmë, brenda një viti nga data në të cilën është krijuar mes tyre marrëdhënia shoqëri mëmë - shoqëri e kontrolluar sipas këtij ligji.”.

Neni 22

Në nenin 140, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.”.

Neni 23

Në nenin 151, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 145, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe/ose për ngritjen e padive të tjera, që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo anëtarëve të këshillit të administrimit a këshillit mbikëqyrës.

2. Aksionarët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit, mund t’i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve ose anëtarëve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës. Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente padi në emër të shoqërisë për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve të përcaktuar më sipër vlerësohet e refuzuar.”.

Neni 24

Në nenin 157 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:
“Shkarkimi dhe dorëheqja”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“4. Anëtari i këshillit të administrimit mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Anëtari i këshillit të administrimit që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e anëtarit të ri të këtij këshilli, përpara datës kur dorëheqja të hyjë në fuqi.



5. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e anëtarit të ri të këshillit të administrimit në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga anëtari i dorëhequr, atëherë administratori apo, në mungesë apo mosveprim të tij, anëtari i dorëhequr, i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, dhe Qendra Kombëtare të Regjistrimit regjistron largimin e anëtarit të këshillit të administrimit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

6. Dorëheqja e anëtarit të këshillit të administrimit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që anëtari ka ndaj saj, sipas këtij ligji.”

Neni 25

Në nenin 158 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalia e katërt ndryshohet si më poshtë:

“Emërimi i administratorëve hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit. Emërimi mund t’u kundrejtohet palëve të treta, sipas parimeve të nenit 12 të këtij ligji.”

2. Pas pikës 7 shtohen pikat 8, 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“8. Administratori, i cili nuk është anëtar i këshillit të administrimit, mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar këtij këshilli. Administratori, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, duhet të përcaktojë në njoftimin e shkruar datën në të cilën dorëheqja hyn në fuqi.

9. Nëse këshilli i administrimit nuk vendos emërimin e administratorit të ri përpara datës, në të cilën dorëheqja hyn në fuqi, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e cila regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

10. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimeve të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

11. Në rastet kur administratori është njëkohësisht anëtar i këshillit të administrimit apo kur, sipas pikës 2, të nenit 167, administratori emërohet nga asambleja e përgjithshme, dispozitat e mësipërme të këtij neni, në lidhje me dorëheqjen e administratorit, nuk zbatohen dhe dorëheqja kryhet sipas pikave 4, 5 dhe 6, të nenit 157, të këtij ligji.”

Neni 26

Në nenin 169, pika 2, fjalët “sipas nenit 113 të këtij ligji,” zëvendësohen me fjalët “sipas nenit 112 të këtij ligji.”

Neni 27

Neni 175 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 175

Kushtet për zmadhimin e kufizuar të kapitalit

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, të cilat mund t’u ofrohen për nënshkrim vetëm aksionarëve ekzistues, në përpjesëtim me aksionet e zotëruara prej tyre përpara rritjes së kapitalit apo duke rritur vlerën nominale të secilit aksion.

2. Me përjashtim të rastit kur rritja e vlerës nominale të secilit aksion vendoset të realizohet me përfshirjen e aktiveve të shoqërisë, sipas nenit 177, të këtij ligji, zmadhimi i kufizuar i kapitalit, në rastet e parashikuara sipas pikës 1, të këtij neni, mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.”

Neni 28

Në nenin 176, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Statuti ose një vendim i asamblesë së përgjithshme për ndryshime në statut mund t’u japë administratorëve të drejtën për të kryer një apo disa herë, brenda një afati 5-vjeçar, përkatësisht, nga regjistrimi i shoqërisë apo nga vendimi i asamblesë, zmadhim të kapitalit me emetim të aksioneve të reja, për një vlerë maksimale të përcaktuar (kapital i autorizuar).”

Neni 29

Neni 187 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 187

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

1. Shoqëria aksionare priset:

a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;

b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;

d) kur, si pasojë e humbjeve ushtrimore, kapitalet e veta të shoqërisë janë në vlerë më të ulët se vlera minimale e kapitalit të regjistruar, të përcaktuar sipas nenit 107, të këtij ligji, apo kur vendoset zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë nën këtë vlerë minimale dhe hyrja në fuqi e këtij zvogëlimi nuk kushtëzohet me realizimin e një zmadhimi vijues, nëpërmjet të cilit shoqëria të rikapitalizohet me kontribute të reja me vlerë, të paktën, sa vlera e nevojshme për të arritur kapitalin minimal të përcaktuar sipas atij neni;

dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

ë) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e aksionarëve.

2. Prishja e shoqërisë si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në përputhje me shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e aksionarëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 145, të këtij ligji.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së aksionarëve për të vendosur prishjen, sipas rasteve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, në çdo kohë, për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si

pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.”

Neni 30

Në nenin 190, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe, prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese. Nëse shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, ajo priset në bazë të vendimeve të përcaktuara nga pika 5 e nenit 43, pika 5 e nenit 99, dhe pika 5 e nenit 187, të këtij ligji, dhe çregjistrohet nga regjistri tregtar, sipas nenit 51, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, pa iu nënshtruar procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.”

Neni 31

Në nenin 197, pika 3, fjalët “nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të këtij ligji,” zëvendësohen me fjalët “nëse, në bazë të pretendimeve të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 195 të këtij ligji.”



Neni 32

Në nenin 199, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Likuiduesi nuk mund të shpërndajë aktivet e mbetura të shoqërisë përpara përfundimit të afatit të depozitimit të pretendimeve të kreditorëve, të përcaktuar sipas nenit 195 të këtij ligji.”.

Neni 33

Në nenin 203, pika 2, në fjalinë e fundit, fjalët “kreditorët, të cilët nuk kanë depozituar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 194” zëvendësohen me fjalët “kreditorët, të cilët nuk kanë depozituar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 195”.

Neni 34

Neni 205 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 205

Çregjistrimi pas likuidimit të thjeshtëzuar

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura në vijim të procedurës së likuidimit të thjeshtëzuar, administratori njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me nenin 49, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.”.

Neni 35

Neni 216 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 216

Marrëveshja dhe raporti i bashkimit

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, të cilat marrin pjesë në bashkim, hartojnë një projekt marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen të paktën:

a) forma, emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive që marrin pjesë në bashkim;

b) raporti i këmbimit të kuotave apo aksioneve dhe çdo shumë e pagueshme në para;

c) kushtet e ndarjes së kuotave apo aksioneve të shoqërisë përthithëse;

ç) data, duke nisur nga e cila zotëruesit e këtyre kuotave apo aksioneve kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit, si dhe çdo kusht i posaçëm që ndikon në ushtrimin e kësaj të drejte;

Faqe | 8264

d) data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse;

dh) të drejtat që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të kuotave, aksioneve, të drejtat e veçanta apo titujt e ndryshëm nga aksionet e shoqërive të përthithura apo çdo masë tjetër e parashikuar në lidhje me ta;

e) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;

ë) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.

2. Përfaqësuesit ligjorë të secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.

3. Çdo shoqëri, që merr pjesë në bashkim, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të këtij ligji, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, projekt-marrëveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen në mënyrë të detyrueshme për të paktën tri vitet e fundit.

4. Shoqëritë, që përmbushin kërkesën e pikës 3, të nenit 214, të këtij ligji, por që kanë qenë të regjistruara për më pak se tre vjet, paraqesin dokumentacionin sipas pikës 3, të këtij neni, vetëm për vitet që kanë qenë të regjistruara.

5. Nëse viti i fundit ushtrimor, të cilit i referohen pasqyrat financiare, të përmendura në pikat 3 ose 4, të këtij neni, është mbyllur në një datë e cila është më e hershme se gjashtë muaj përpara datës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit, atëherë, me përjashtim të rastit kur sipas ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”, shoqëria ka hartuar dhe u ka vënë në dispozicion



aksionarëve raporte financiare gjashtë mujore, shoqëria harton gjithashtu pasqyra kontabël për gjendjen e shoqërisë në një datë, e cila nuk duhet të jetë më e hershme se dita e parë e muajit të tretë përpara datës së hartimit të projekt marrëveshjes së bashkimit dhe i publikon ato sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri pjesëmarrëse në bashkim duhet të njoftojnë asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së tyre, si dhe organet e administrimit të shoqërive të tjera që marrin pjesë në bashkim, më qëllim njoftimin e asambleve të përgjithshme të shoqërive përkatëse në lidhje me çdo ndryshim thelbësor në aktivet dhe pasivet e shoqërisë, nga data në të cilën është hartuar projekt marrëveshja e bashkimit, deri në datat e caktuara për mbledhjet e asambleve të përgjithshme që do të vendosin mbi miratimin e projekt marrëveshjes së bashkimit.

7. Detyrimi për hartimin e raportit të përmendur në pikën 2, të pasqyrave kontabël të përmendura në pikën 5, si dhe të njoftimit sipas pikës 6, të këtij neni, mund të përjashtohet me miratimin e të gjithë ortakëve/aksionarëve me të drejtë vote të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim.”

Neni 36

Në nenin 217, pika 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, raporti i vlerësimit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur sipas kësaj metode i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit.”

Neni 37

Në nenin 218 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Secili aksionar apo ortak i shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ka të drejtë të kërkojë e të marrë nga shoqëria, pa pagesë, kopje të plotë apo të pjesshme të dokumenteve, në bazë të të

cilave kryhet bashkimi, sipas neneve 216 dhe 217. Nëse aksionari apo ortakë ka pranuar kryerjen e njoftimeve nga shoqëria në formë elektronike, këto dokumente mund t’i dërgohen me postë elektronike.”

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Shoqëria do të përjashtohet nga detyrimi për të mbajtur në dispozicion në selinë e saj dokumentacionin që duhet t’u jepet ortakëve apo aksionarëve, sipas pikës 3, nëse për një periudhë të pandërprerë, e cila nis një muaj përpara datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme për miratimin e projekt marrëveshjes së bashkimit, ky dokumentacion u vihet në dispozicion ortakëve apo aksionarëve, pa pagesë, për t’u parë, shkarkuar apo për të marrë kopje në formë shkresore në faqen e internetit të shoqërisë. Për çdo ndërprerje të përkohshme të mundësisë për të hyrë në faqen e internetit të shoqërisë, për arsye teknike apo arsye të tjera, afati një mujor i publikimit ndërpritet dhe rinis nga e para në momentin kur faqja e internetit të shoqërisë bëhet sërish e arritshme.”

Neni 38

Neni 225 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 225

Bashkimi me përthithje në raste të veçanta

1. Nëse shoqëria përthithëse zotëron mbi 90 për qind ose të gjithë kapitalin e shoqërisë aksionare që do të përthithet, atëherë bashkimi me përthithje ndërmjet këtyre shoqërive mund të kryhet pa miratimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përthithëse, nëse:

a) publikimet, sipas pikës 3, të nenit 216, janë kryer në lidhje me shoqërinë përthithëse, të pakën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të saj apo të shoqërive të tjera, objekt të përthithjes, që do të miratojnë projekt marrëveshjen e bashkimit; dhe

b) të pakën një muaj përpara datës së caktuar sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, të gjithë aksionarët apo ortakët e shoqërisë përthithëse kanë të drejtë të njihen me dokumentacionin, në përputhje me nenet 216 dhe 217, në selinë e regjistruar të shoqërisë përthithëse. Parashikimet e



pikave 3 dhe 4, të nenit 218, janë të zbatueshme edhe në këtë rast; dhe

c) aksionarët ose ortakët e shoqërisë përthithëse, që zotërojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të saj apo të numrit të përgjithshëm të votave, nuk kërkojnë thirrjen e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përthithëse për miratimin e bashkimit.

2. Nëse të gjitha aksionet e shoqërisë, që do të përthithet, që japin të drejta vote në asamblenë e përgjithshme, zotërohen nga shoqëria përthithëse, atëherë kërkesat, sipas parashikimeve të neneve 216, pika 1, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, dhe 2, 217, 218, pikat 3 dhe 4, 220, pika 3, shkronja “b”, të këtij ligji, nuk zbatohen.

3. Nëse shoqëria përthithëse zotëron të paktën 90 për qind, por jo të gjithë kapitalin e shoqërisë aksionare që do të përthithet, atëherë bashkimi ndërmjet këtyre shoqërive mund të kryhet pa miratimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përthithëse dhe kërkesat, sipas parashikimeve të neneve 216, pika 2, 217 dhe 218, pikat 3 dhe 4, nuk zbatohen, nëse aksionarët e pakicës së shoqërisë që përthithet kanë të drejtën t’ia shesin aksionet e tyre me vlerë tregu shoqërisë përthithëse. Në rast mosmarrëveshjeje, në lidhje me përcaktimin e kësaj vlere, aksionarët e pakicës së shoqërisë që përthithet kanë të drejtë të kërkojnë që vlera e tregut për shitjen e aksioneve të tyre të përcaktohet nga gjykata.”.

Neni 39

Nenet 230 dhe 231 shfuqizohen.

Neni 40

Dispozita të fundit dhe kalimtare

1. Pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, asnjë shoqëri tregtare nuk mund të priset për shkak të mospërbushjes përpara kësaj date të kërkesave të nenit 230, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

2. Shoqëritë tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar përpara datës 20.5.2008, të cilat në datën hyrjes në fuqi të këtij ligji ende nuk kanë adaptuar statutin e tyre me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, janë të detyruara që jo më vonë se 3 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji:

a) të miratojnë ndryshimet e nevojshme në statutin e tyre për ta përputhur atë me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;

b) t’i regjistrojnë këto ndryshime të statutit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

3. Mospërbushja e detyrimeve, sipas pikës 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 30 000 lekë. Gjoha aplikohet dhe vilet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ndërpret shërbimin për këto shoqëri deri në kryerjen e veprimeve, sipas përcaktimit të shkronjave “a” ose “b”, të pikës 2, të këtij neni, dhe në pagesën e plotë të gjobës.

4. Afati 3-mujor, i përmendur në pikën 2, është afat për zbatimin e detyrimeve të regjistrimit sipas pikës 2, të këtij neni, dhe, në asnjë rast, nuk mund të përdoret si justifikim për moszbatimin e plotë të dispozitave në fuqi të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

5. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ngarkohet të nisë dhe të vazhdojë deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, fushata informuese për publikun në faqen e saj në internet, si dhe në ambientet e sporteleve të saj në qendër dhe në sportelet e tjera të saj të shërbimit për detyrimet, sipas këtij neni.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8747, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



LIGJ
Nr. 130/2014

**PËR DISA SHTESA DHE NJË
NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8752, DATË
26.3.2001, “PËR KRIJIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE TË
ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË
TOKËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, të ndryshuar, në nenin 11/1 bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Pas pikës 5/1 shtohen pikat 5/2, 5/3 dhe 5/4 me këtë përmbajtje:

“5/2. Në tokat bujqësore, në të gjitha kategoritë e bonitetit, miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5/3. Për objektet e parashikuara në pikën 5/2 të këtij neni, në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

5/4. Tipat e objekteve, të parashikuara në pikën 5/2 të këtij neni, rregullat, kriteret dhe procedurat për ndërtimin e tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

b) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Rregullat dhe procedurat për ndryshimet e kategorive të resurseve, sipas pikave 1 deri në 5/2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 1 të tij.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8748, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 131/2014

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË
NË LIGJIN NR. 9244, DATË 17.6.2004,
“PËR MBROJTJEN E TOKËS
BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 14 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8749, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



LIGJ
Nr. 132/2014

**PËR RATIFIKIMIN E
MARRËVESHJES NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BASHKIMIT EUROPIAN PËR
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN KUADËR
“HORIZON 2020 - PROGRAMI PËR
KËRKIM DHE INOVACION”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër “Horizon 2020 - programi për kërkim dhe inovacion”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8750, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**MARRËVESHJE
NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
BASHKIMIT “HORIZON 2020 –PROGRAMI
KUADËR PËR KËRKIM DHE INOVACION
(2014-2020)”**

Komisioni Evropian, tani e tutje referuar si “Komisioni”, në emër të Bashkimit Evropian, Nga njëra palë, dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, tani e tutje referuar si “Shqipëria”, nga pala tjetër, më poshtë së bashku referuar si “Palët”,

Duke pasur parasysh se:

1. Marrëveshja kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit u miratua më 6 qershor 2005 dhe hyri në fuqi më 11 korrik 2005 (më poshtë e quajtur “Marrëveshje kuadër”,² duke lënë autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe Komisionin që të përcaktojnë në një memorandum mirëkuptimi³ termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë edhe kontributin financiar në lidhje me këtë pjesëmarrje, në secilin program të veçantë;

2. Programi i ri i Bashkimit për kërkim dhe inovacion, “Horizon 2020- Programi kuadër për kërkim dhe inovacion (2014-2020)”, tani e tutje i quajtur “Programi”, është themeluar me rregullore nr. 1291/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian⁴;

3. “Horizon 2020” synon të kontribuojë në arritjen e Zonës Evropiane Kërkimore dhe Bashkimin e Inovacionit;

4. Në pajtim me nenin 7 të rregullores (BE) nr. 1291/2013, në përputhje me “Horizon 2020”, kushtet dhe termat specifike në lidhje me pjesëmarrjen, ku përfshihet dhe kontributi financiar, i cili duhet të bazohet në prodhimin e brendshëm bruto të vendit të asociuar, do të përcaktohet nga një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit dhe vendit të asociuar⁵,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi - Programi

1. Shqipëria do të marrë pjesë si një vend i asociuar në “Program”, bazuar në:

Rregulloren e (BE) nr. 1291/2013, për krijimin e “Horizon 2020- programi kuadër për kërkim dhe inovacion (2014-2020)”;

² OJ L 192, 22.7.2005, f. 2

³ Kjo marrëveshje ndërkombëtare përbën dhe ka të njëjtat efekte ligjore si Memorandumi i Mirëkuptimit i deklaruar në bazë të Marrëveshjes Kuadër mbi termat dhe kushtet specifike në programet e Komunitetit.

⁴ Rregullorja e (BE) e Parlamentit dhe Këshillit Evropian në krijimin e Horizon 2020- Programi Kuadër për Kërkim dhe Inovacion (2014-2020) dhe shfuqizimi i vendimit nr. 1982/2006/EC(OJ L347, f. 104, 20.12.2013).

⁵ Rregullorja e (BE) e Parlamentit dhe Këshillit Evropian në krijimin e Horizon 2020- Programi Kuadër për Kërkim dhe Inovacion (2014-20) (OJ L 347).



Rregulloren e (BE) nr. 1291/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 11 dhjetor 2013⁶, ku përcaktohen rregullat për pjesëmarrjen dhe përhapjen në “Horizon 2020-Programi kuadër për kërkim dhe inovacion (2014-2020)” dhe shfuqizimin e rregullores (KE) nr. 1906/2006, duke përfshirë aktet e deleguara dhe rregulla të tjera pasuese;

Vendimin nr. 2013/743/BE i Këshillit për Krijimin e Programit Specifik mbi zbatimin e Horizon 2020⁷ dhe ndonjë rregull tjetër që ka të bëjë me zbatimin e programit “Horizon 2020”.

2. Rregullorja nr. 294/2008/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e ndryshuar me rregulloren (BE) nr. 1292/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e cila krijon Institutin Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë, do të zbatohet gjithashtu lidhur me pjesëmarrjen e subjekteve shqiptare në Komunitetet e Njohurisë dhe Inovacionit⁸.

Neni 2

Termet dhe kushtet e pjesëmarrjes në Program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Program, termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe anekset e saj.

Subjektet ligjore të krijuara në Shqipëri do të marrin pjesë në veprime indirekte të Programit, sipas kushteve të njëjta, si ato të zbatueshme për subjektet ligjore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, subjekt i termave dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje.

2. Subjektet ligjore të krijuara në Shqipëri do të marrin pjesë në veprimet e Qendrës së Përbashkët Studimore të Programit, sipas të njëjtave kushte që zbatohen për subjektet ligjore të shteteve anëtare në Bashkimin Evropian.

3. Subjektet ligjore të krijuara në Shqipëri do të marrin pjesë në aktivitetet e Komuniteteve të Njohurisë dhe Inovacionit.

4. Në rast se Bashkimi merr masa për zbatimin e neneve 185 dhe 187 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Shqipëria do të lejohet të marrë pjesë në strukturat ligjore të krijuara sipas këtyre masave, në përputhje me vendimet dhe rregullat aktualisht në fuqi ose që do të miratohen në të ardhmen për krijimin e këtyre strukturave ligjore.

5. Për pjesëmarrjen në Program, Shqipëria do t'i paguajë kontributin e saj financiar buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë dhe aneksit II.

6. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të lejohen të marrin pjesë si vëzhgues në komitetet përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e Programit, për të cilin Shqipëria kontribuon financiarisht dhe për pikat, të cilat kanë të bëjnë me Shqipërinë.

Këto komitete do të takohen pa prezencën e përfaqësuesve të Shqipërisë në kohën e votimit. Shqipëria do të njoftohet për rezultatin.

Pjesëmarrja siç përmendet në këtë paragraf do të marrë të njëjtën formë, përfshirë procedurat për marrjen e informacionit dhe të dokumentacionit si ato që zbatohen për përfaqësuesit nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

7. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të marrin pjesë në Bordin e Guvernatorëve të Qendrës së Përbashkët Kërkimore në përputhje me rregullat dhe procedurat për Bordin e Guvernatorëve të Qendrës së Përbashkët Kërkimore. Pjesëmarrja siç referohet dhe në këtë paragraf do të marrë të njëjtën formë, duke përfshirë procedurat për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit, të njëjta me ato që aplikohen për përfaqësues nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

8. Një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit, në këtë rast gjuha angleze, do të përdoret për procedurat lidhur me kërkesat, marrëveshjet dhe raportet e mëdha, gjithashtu dhe për aspektet e tjera ligjore dhe administrative të Programit.

9. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet për jetesën të kryera nga përfaqësuesit dhe ekspertët shqiptarë për pjesëmarrje si vëzhgues në punën e Komitetit referuar në nenin 10.1 të vendimit nr. 743/2013/BE “Për krijimin e Programit Specifik për zbatimin e “Horizon

⁶Rregullore e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, ku përcaktohen rregullat për pjesëmarrjen dhe përhapjen në Horizon 2020-(OJ L 347).

⁷ Vendim i Këshillit për krijimin e programit specifik (OJ L 347) nr. 2013/743/BE

⁸Rregullore (BE) nr. 1292/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 11 dhjetor 2013, e ndryshuar me rregulloren (KE) nr. 294/2008 “Për krijimin e Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë” (OJ L 347).



2020” ose mbledhje të tjera lidhur me zbatimin e Programit, do të rimbursohen nga Komisioni sipas të njëjta rregulla dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 3

Kontributi financiar

1. Për çdo vit pjesëmarrjeje në Program, Shqipëria do t'i paguajë një kontribut financiar buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

Kontributi financiar i Shqipërisë do t'i shtohet shumës së caktuar për secilin vit në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, për përvetësim angazhimi për të përmbushur detyrimet financiare që dalin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për zbatim, menaxhim dhe operim të programit.

2. Pjesë e kontributit financiar të Shqipërisë, nëse Shqipëria e kërkon këtë, mund të financohet nga instrumentet e jashtme përkatëse të Bashkimit.

3. Rregullat qeverisëse për kontributin financiar të Shqipërisë janë vendosur në aneksin II të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës së Auditorëve të Bashkimit Evropian në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program vazhdimisht do të monitorohet mbi bazat e partneritetit, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë.

2. Rregullat për kontrollin financiar, masat e rimëkëmbjes dhe rregullat e tjera kundër mashtrimit përcaktohen në aneksin III të kësaj Marrëveshjeje.

3. Shqipëria gjithashtu do t'i paraqesë Komisionit raporte lidhur me qëllimin e vlerësimit të pjesëmarrjes së saj në Program dhe diskutimet në Komitetin e Përbashkët themeluar nga kjo Marrëveshjeje.

Neni 5

BE-Komiteti Shqiptar i Kërkimit dhe Inovacionit

1. Sipas kësaj Marrëveshjeje do të krijohet një komitet që do të quhet “Komiteti i Kërkimit dhe

Inovacionit BE-Shqipëri” dhe tani e tutje referuar si “Komiteti i Përbashkët”.

2. Funkcionet e Komitetit të Përbashkët do të përfshijnë:

-sigurimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

-shqyrtimin e çdo mase për të përmirësuar dhe zhvilluar bashkëpunimin.

3. Puna e Komitetit të Përbashkët do të jetë plotësuese për to dhe në përputhje me punën e komiteteve dhe organeve të tjera të krijuara sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-Komunitetet Evropiane⁹.

4. Komiteti i Përbashkët duhet t'i përshtatet kërkesave të secilës Palë. Komiteti duhet të miratojë rregulloren e tij të brendshme.

5. Komiteti i Përbashkët duhet të përbëhet nga përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Pas nënshkrimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Shqipëria të ketë njoftuar Komisionin se procedurat e saj të brendshme për këtë qëllim kanë përfunduar.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të jetë përkohësisht e zbatueshme pas nënshkrimit. Ajo do të zbatohet që nga 1 janari 2014 dhe për të gjithë kohëzgjatjen e Programit.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Programit, duke informuar me njoftim mbi qëllimin e përfundimit të pjesëmarrjes në Program.

Në pajtim me dispozitat tani e tutje, përfundimi do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës në të cilën njoftimi me shkrim të ketë arritur deri tek adresuesi.

Mbarimi dhe/ose përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë:

a) Çdo projekt apo aktivitet në proces

b) Zbatimin e çdo marrëveshjeje kontraktuale të këtyre projekteve dhe aktiviteteve, siç përcaktohet në nënparagrafin 2 (a) më sipër.

⁹Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, hyrë në fuqi më 1 prill 2009 (OJ L 107, 28.04.2009, fq. 166)



Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, Bashkimi do t'i rimbursojë Shqipërisë pjesën e kontributit të saj buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian, e cila nuk do të shpenzohet për shkak të përfundimit.

3. Anekset janë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

4. Kjo Marrëveshje mund të ndryshojë vetëm me shkrim me pëlqim të përbashkët të Palëve.

5. Asociimi i Shqipërisë në Programin Kuadër të mëvonshëm për Kërkim dhe Risi, me kërkesë të palës shqiptare, do të jetë subjekt i një marrëveshjeje të re për të cilën palët duhet të bien dakord.

E bërë në Bruksel, më 1 korrik, në vitin dy mijë e katëmbëdhjetë, në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe, secili nga këto tekste janë njëloj autentikë.

Për Komisionin në emër të Bashkimit Evropian

Robert-Jan Smits

Drejtor i Përgjithshëm për Kërkim dhe Inovacion

Për Republikën e Shqipërisë

Lindita Nikolla

Ministër i Arsimit dhe Sportit

ANEKSI I

TERMAT DHE KUSHTET PËR PJESËMARRJE TË SUBJEKTEVE LIGJORE TË SHQIPËRISË NË PROGRAM

1. Me qëllim pjesëmarrjen e Shqipërisë në Program, një subjekt ligjor shqiptar përkufizohet si një person fizik ose person juridik i krijuar në Shqipëri sipas ligjit vendas, i cili ka personalitet juridik dhe që mund të veprojë në emër të tij, të ushtrojë të drejta dhe t'u nënshtrohet detyrimeve. Në rastin e personave fizikë, referencat për themelimin konsiderohen se i referohen vendbanimit të zakonshëm.

2. Pjesëmarrja e subjekteve ligjore të Shqipërisë në Program do të ndjekë kushtet e vendosura për subjektet ligjore të krijuara në një "vend të asociuar", ashtu siç specifikohet në rregullat për pjesëmarrje.

Subjektet ligjore të krijuara në Shqipëri duhet të jenë të pranueshëm për instrumentet financiare të krijuara sipas Programit "Horizon 2020".

Një subjekt juridik i themeluar në një vend tjetër dhe ky pjesë e Programit gëzon të njëjtat të

drejta dhe detyrime sipas kësaj Marrëveshjeje, si personat juridikë që janë vendosur në një shtet anëtar, me kusht që vendi në të cilin është themeluar subjekti të ketë rënë dakord që t'u garantojë subjekteve juridike nga vendet e tjera të njëjtat të drejta dhe detyrime.

3. Subjektet ligjore shqiptare do të merren në konsideratë njësoj si ato të Bashkimit për përzgjedhjen e ekspertëve të pavarur për detyrat, dhe sipas kushteve të parashikuara në rregullat për pjesëmarrje.

4. Palët do të bëjnë çdo përpjekje brenda kuadrit të masave ekzistuese, për të lehtësuar lëvizjen e lirë dhe vendbanimin e shkencëtarëve që marrin pjesë në aktivitetet e mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve që synohen të përdoren në këto aktivitete.

5. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që mallra dhe shërbime të blera në Shqipëri ose të importuara në Shqipëri, të cilat janë pjesërisht ose plotësisht të financuara në pajtim me marrëveshjen grant e dhe/ose kontratat e përfunduara për realizimin e aktiviteteve, sipas kësaj Marrëveshjeje, të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit dhe nga pagesat e tjera fiskale që zbatohen në Shqipëri, duke përfshirë dhe TVSH-në.

ANEKSI II

RREGULLAT PËR QEVERISJEN E KONTRIBUTIT FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAM (2014-2020)

I. Përlllogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Program do të krijohet mbi bazat vjetore në raport me, dhe përveç shumës në dispozicion për atë vit të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian për ndarjet buxhetore të angazhimit të nevojshëm për zbatim, menaxhim dhe operim të Programit.

2. Faktori i përpjesëtuashmërisë që qeveris kontributin e Shqipërisë është i barabartë me raportin ndërmjet prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë me çmimin e tregut, dhe shumën e prodhimeve të brendshme bruto me çmimet e tregut të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

Produktet vendase bruto do të jenë të fundit të publikuara për të njëjtin vit nga Zyra Statistikore e Komuniteteve Evropiane (EUROSTAT), të



disponueshme në kohën e negocimit të kësaj Marrëveshjeje (d.m.th. 2011). Pasi faktori i përpjesëtueshmërisë të jetë caktuar për vitin e parë të pjesëmarrjes, ai do të mbetet i fiksuar për vitet në vijim.

Në mënyrë që të lehtësohet pjesëmarrja e saj në Program, kontributi i Shqipërisë do të krijohet për vitin respektiv financiar, duke aplikuar një faktor korigjimi prej 0.15 si më poshtë:

- Viti financiar 2014: kontributi sipas paragrafit 1 dhe faktorit të përpjesëtueshmërisë të caktuar në përputhje me paragrafin 2, shumëzuar me 0,15;

- Viti financiar 2015: kontributi sipas paragrafit 1 dhe faktorit të përpjesëtueshmërisë të caktuar në përputhje me paragrafin 2, shumëzuar me 0,15;

- Viti financiar 2016: kontributi sipas paragrafit 1 dhe faktorit të përpjesëtueshmërisë të caktuar në përputhje me paragrafin 2, shumëzuar me 0,15;

- Viti financiar 2017: kontributi sipas paragrafit 1 dhe faktorit të përpjesëtueshmërisë të caktuar në përputhje me paragrafin 2, shumëzuar me 0,15;

- Viti financiar 2018: kontributi sipas paragrafit 1 dhe faktorit të përpjesëtueshmërisë të caktuar në përputhje me paragrafin 2, shumëzuar me 0,15;

- Viti financiar 2019: kontributi sipas paragrafit 1 dhe faktorit të përpjesëtueshmërisë të caktuar në përputhje me paragrafin 2, shumëzuar me 0,15;

- Viti financiar 2020: kontributi sipas paragrafit 1 dhe faktorit të përpjesëtueshmërisë të caktuar në përputhje me paragrafin 2, shumëzuar me 0,15;

4. Në vitin e katërt, pasi kjo marrëveshje të bëhet e zbatueshme, Palët do të shqyrtojnë faktorin e korigjimit që rregullon kontributin financiar të Shqipërisë, në bazë të të dhënave në lidhje me pjesëmarrjen e subjekteve të Shqipërisë në veprime indirekte dhe të drejtpërdrejta në Program gjatë viteve 2014-2016.

5. Komisioni do t'ia komunikojë Shqipërisë sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 1 shtatori i vitit përpara çdo viti financiar, informacionin e mëposhtëm, së bashku me materialin përkatës:

- Shumat, nëndarjet buxhetore të angazhimit financiar në pasqyrën e shpenzimeve të projektbuxhetit të Bashkimit Evropian që korrespondojnë me Programin;

- Shuma e vlerësuar e kontributeve të përfuara nga projektbuxheti që korrespondon me pjesëmarrjen e Shqipërisë në Program sipas paragrafëve më lart 1, 2, 3 dhe 4.

Sapo buxheti i përgjithshëm të jetë miratuar përfundimisht, Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, shumat përfundimtare referuar në nënparagrafin e parë.

II. Pagesat e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Komisioni do të lëshojë, jo më vonë se data 30 janar dhe 15 qershor të çdo viti financiar, një thirrje për fonde Shqipërisë që korrespondon me kontributin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Këto thirrje për fonde do të sigurojnë përkatësisht pagesën e:

- gjashtë të dymbëdhjetës së kontributit shqiptar, jo më vonë se data 15 mars; dhe

- gjashtë të dymbëdhjetës së kontributit shqiptar, jo më vonë se data 20 korrik.

Thirrja e parë për fonde për çdo vit financiar do të llogaritet në bazë të shumës së caktuar në deklarin e të ardhurave të projektbuxhetit: rregullimi i shumës së paguar në këtë mënyrë do të bëhet me pagesën e thirrjes së dytë për fonde për të njëjtin vit financiar.

Për vitin e parë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të shpallë thirrjen e parë për fonde me efekt prapaveprues, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi. Nëse kjo thirrje do të shpallet pas 15 qershorit, ajo do të kërkojë pagesën e dymbëdhjetë/dymbëdhjetave të kontributit të Shqipërisë, brenda 30 ditëve, të llogaritur mbi bazën e shumës së caktuar në deklarin e të ardhurave të buxhetit.

3. Në vitin e fundit të Programit Komisioni do të shpallë një thirrje për fonde jo më vonë se 15 qershor duke kërkuar shumën e plotë të kontributit të Shqipërisë për vitin financiar 2020, që duhet paguar jo më vonë se 20 korrik 2020.

4. Kontributi i Shqipërisë do të shprehet dhe paguhet në euro.

5. Pagesa e Shqipërisë do të kreditohet në programet e Bashkimit, si pranime buxhetore të shpërndarë sipas zërave në kreun e përshtatshëm buxhetor, në pasqyrën e të ardhurave të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian. Rregullatori financiar i zbatueshëm në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të zbatohet për menaxhimin e hyrjeve/pranimeve.

6. Shqipëria do të paguajë kontributin sipas kësaj Marrëveshjeje, ashtu siç specifikohet në pikën II.2 të aneksit II.



Çdo vonesë në pagesë do të shkaktojë pagesën e kamatëvonesave nga Shqipëria mbi shumën e papaguar nga data e caktuar. Norma e interesit për shumën e kërkuara të papaguara në datën e caktuar do të jetë norma e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e rfinansimit të principalit, ashtu siç janë publikuar në serinë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, bazuar në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilën bie data e caktuar, rritur me një pikë e gjysmë përqindjeje.

Në rast se vonesa në pagesë e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program mund të pezullohet nga Komisioni nëse pagesa nuk është kryer ende edhe pas 20 ditë pune pas një letër-kujtese formale, pa cenuar detyrimet e Bashkimit, sipas marrëveshjeve grant dhe/ose kontratave tashmë të përfunduara që kanë të bëjnë me zbatimin e veprimeve indirekte për të cilat është përzgjedhur Shqipëria.

7. Jo më vonë se data 30 qershor e vitit që pason një vit financiar, deklarata e shumave të përcaktuara për Programin e atij viti financiar do t'i përgatitet dhe do t'i transmetohet Shqipërisë për informacion, sipas formatit të llogarisë së shpenzimeve dhe të ardhurave të Komisionit.

8. Komisioni, në kohën e mbylljes së llogarisë lidhur me secilin vit financiar, brenda kuadrit të krijimit të llogarisë për të ardhurat dhe shpenzimet, do të vazhdojë rregullimin e llogarive duke pasur parasysh pjesëmarrjen e Shqipërisë.

Ky rregullim do të marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur, qoftë me transferim, pezullim, vonesa, mosangazhime ose nga buxhetet shtesë apo të ndryshuara gjatë vitit financiar.

Ky rregullim do të ndodhë në kohën e pagesës së dytë për vitin e ardhshëm financiar dhe për vitin e fundit në qershor 2021. Rregullime të mëtejshme do të ndodhin çdo vit deri në 2023.

ANEKSI III KONTROLI FINANCIAR I SHQIPËRISË NË PROGRAM

I. Komunikimi direkt

Komisioni mund të komunikojë drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në Programin e themeluar në Shqipëri dhe me nënkontraktorët e tyre. Ata mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjitha

informacionet dhe dokumentet, të cilat janë të detyruar t'i paraqesin në bazë të instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje dhe të marrëveshjeve të grantit dhe /ose kontratave të rëndësishme, lidhur me zbatimin e tyre.

II. Auditimi

1. Në përputhje me rregulloren e Parlamentit Evropian dhe rregulloren e Këshillit (BE, Euratom) nr. 966/2012¹⁰(tani e tutje referuar si "Rregullore financiare") dhe rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) nr. 1268/2012¹¹(tani e tutje referuar si "Rregullat e aplikimit") dhe me rregullat e tjera referuar me këtë Marrëveshje, marrëveshjet-grant dhe/ose kontratat e lidhura me pjesëmarrësit në Program, të krijuara në Shqipëri, mund të parashikojnë auditime shkencore, financiare, teknologjike ose të tjera për t'u kryer në çdo kohë në ambientet e pjesëmarrësve dhe nënkontraktorëve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit, Gjykata Evropiane e Auditimit dhe persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni duhet të kenë mundësi të përshtatshme hyrjeje në faqet elektronike, punët, dokumentet (version elektronik dhe me letër) dhe në të gjithë informacionin e kërkuar, në mënyrë që të kryejnë auditet/kontrollet të tilla si subjekt i përfshirjes në këtë të drejtë për hyrje, e cila do të përcaktohet shprehimisht në marrëveshjet grantit dhe/ose kontratat e lidhura për të zbatuar instrumentet referuar, kësaj Marrëveshjeje, me pjesëmarrësit nga Shqipëria. Mossigurimi i këtyre të drejtave do të shikohet si një dështim për të verifikuar/provuar kostot e për pasojë si një shkelje e fuqishme e marrëveshjes grant.

3. Kontrollet/auditimet mund të bëhen pas Programit ose pas përfundimit së kësaj Marrëveshjeje, sipas kushteve të caktuara në marrëveshjet grant dhe/ose kontratat në fjalë. Çdo auditim i kryer pas përfundimit të Programit ose kësaj Marrëveshjeje do të kryhet në përputhje me kushtet e vendosura në këtë aneks.

¹⁰Rregullore (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 25 tetor 2012 mbi rregullat e aplikueshme financiare të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit(OJ L 298,26.10.2012)

¹¹Rregullore Delegruese e Komisionit (BE) nr. 1268/2012, 29 tetor 2012 mbi rregullat e zbatueshme të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi rregullat financiare të zbatueshme në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit (OJ L 362, 31.12.2012)



III. Mbi kontrollet në vend nga Komisioni (OLAF)

1. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni dhe veçanërisht Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (ZEKM) do të autorizohet të kryejë kontrole dhe inspektime në ambientet e pjesëmarrësit dhe nënkontraktorët e tyre nga Shqipëria. Në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara në rregulloren e Këshillit (Euratom, KE) nr. 2185/96¹².

2. Kontrollat dhe inspektimet do të përgatiten dhe kryhen nga Komisioni në bashkëpunim të ngushtë me autoritet kompetente shqiptare të caktuara nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë.

Për qëllimin e përmendur në këtë paragraf të aneksit III, autoriteti i caktuar shqiptar do të jetë Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës e Akredituar nga BE-ja. Autoriteti i caktuar do të njoftohet në një kohë të arsyeshme më parë për objektin, qëllimin dhe bazat ligjore të kontroleve ose inspektimeve, në mënyrë që të ata mund të ofrojnë ndihmë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente shqiptare mund të marrin pjesë në kontrollet ose inspektimet në vend.

3. Nëse autoritetet shqiptare të interesuara dëshirojnë, kontrollet në terren dhe inspektimet mund të kryhen bashkërisht nga Komisioni dhe ata.

4. Nëse pjesëmarrësit në Program kuadër shtojnë kontrollin ose inspektimin, autoritet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, do të ndihmojnë inspektorët e Komisionit në një masë të arsyeshme sa të jetë e nevojshme për t'i lejuar ata të përmbushin detyrat e tyre për kryerjen e kontroleve ose inspektimeve.

5. Komisioni do t'i raportojë sa më shpejt që të jetë e mundur autoritetit kompetent shqiptar çdo fakt ose dyshim lidhur me parregullsitë, të cilat janë sjellë në vëmendje të tyre gjatë kontrollit ose inspektimit. Në çdo rast, Komisionit do t'i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatet e këtyre kontroleve ose inspektimeve.

IV. Informacion dhe konsultë

1. Me qëllim zbatimit e duhur të këtij aneksi, autoritet kompetente të Bashkimit dhe ato shqiptare do të shkëmbejnë rregullisht informacion,

vetëm në rast se ndalohen ose nuk autorizohen nga rregullat kombëtare dhe me kërkesë të njëres palë, do të zhvillojnë konsultime.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë Komisionin, brenda kohës së arsyeshme për çdo fakt ose dyshim, i cili ka ardhur në dijeni të tyre mbi ndonjë parregullsi lidhur me kryerjen dhe zbatimin e marrëveshjes së grantit dhe/ose kontratës të lidhur në zbatim të instrumenteve të kësaj Marrëveshjeje.

V. Konfidencialiteti

Informacioni i komunikuar ose i fituar në çdo formë, sipas këtij aneksi, do të ruhet nga fshehtësia profesionale dhe do të mbrohet në të njëjtën mënyrë siç mbrohet informacioni i ngjashëm nga ligji shqiptar dhe nga dispozitat përkatëse të zbatueshme për institucionet e Bashkimit. Informacioni i tillë mund të mos u komunikohet personave, përveç atyre brenda institucioneve të Bashkimit, ose në shtetet anëtare ose të Shqipërisë, funksionet e të cilëve ligjërisht u kërkojnë atyre ta njohin atë, dhe as nuk mund të përdoren për qëllime, përveç se të sigurojnë mbrojtje efektive mbi interesin financiar të palëve¹³.

VI. Masat administrative dhe ndëshkimet

Pa cenuar aplikimin e Kodit Penal shqiptar, masa administrative dhe ndëshkime mund të imponohen nga Komisioni në përputhje me rregulloret e (BE, Euratom) nr. 966/2012 (BE) nr. 1268/2012 dhe (KE, Euratom) nr. 2988/95¹⁴.

VII. Rimëkëmbja dhe zbatimi

Vendimet e marra nga Komisioni për Programin sipas kësaj Marrëveshjeje, e cila vendos një detyrim financiar për personat përveç shteteve, do të jenë të detyrueshme në Shqipëri. Nëse kërkohet nga Komisioni, autoriteti i caktuar nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë duhet të fillojë procedurat për zbatimin e vendimit në emër të Komisionit. Në këtë rast vendimi i Komisionit do t'i paraqitet Gjykatës Shqiptare, pa formalitete të tjera, përveç verifikimit të origjinalitetit të vendimit nga autoriteti i caktuar për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë, i cili do të informojë Komisionin për sa më sipër. Zbatimi do të hyjë në fuqi në përputhje me ligjin dhe rregullat e procedurës shqiptare.

¹³OJ L 312, 23.12.1995, f. 1

¹⁴Rregullore e Këshillit (KE, Euratom) nr. 2988/95, 18 dhjetor 1995 mbi mbrojtjen e interesit financiar të Komuniteteve Evropiane (OJ L 312, 23.12.1995)

¹²OJ L 312, 23.12.1995, f. 1.



Dispozitat përkatëse të zbatimit do të përfshihen në marrëveshjet grant dhe/ose kontratat me pjesëmarrës nga Shqipëria. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian do të ketë juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit dhe të pezullojë zbatimin e tij. Për më tepër, gjykatat e Shqipërisë do të kenë juridiksion mbi ankesat që ekzekutimi po bëhet në mënyrë të parregullt.

LIGJ
Nr. 133/2014

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN NË LIDHJE ME NJË AMENDAMENT TË KONVENTËS SË AVIACIONIT CIVIL NDËRKOMBËTAR (NENI 3 BIS), TË NËNSHKRUAR NË MONTREAL MË 10 MAJ 1984

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin në lidhje me një amendament të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar (neni 3 bis), të nënshkruar në Montreal më 10 maj 1984.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8751, datë 17.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLL

NË LIDHJE ME NJË AMENDAMENT TË KONVENTËS SË AVIACIONIT CIVIL NDËRKOMBËTAR

[Neni 3 bis]

Nënshkruar në Montreal më 10 maj 1984

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E AVIACIONIT CIVIL

Publikuar nën Autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, të cilit duhet t'i drejtohet e gjithë korrespondenca, me përjashtim të pagesave dhe anëtarësimit.

Pagesat duhet të dërgohen në një nga adresat e mëposhtme, bashkë me vlerën përkatëse (me faturë bankare, çek ose mandat pagese) në dollarë amerikanë ose monedhën e shtetit në të cilin kryhet pagesa. Pagesat me kartë krediti (American Express, MasterCard dhe Visa) pranohen nga zyrat qendrore të ONAC.

Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, në vëmendje të: Njesisë së Shitjes së Dokumenteve 999 University Street, Montreal, Quebec, Canada H3C 5H7

Tel: (514) 954-8022; Teleks: 05-24513; Faks; (514) 954-6769; Sitatex; YULADYA;

E-mail: sales_unit@icao.int

Egjypt. Drejtor Rajonal i ICAO-s, Zyra e Lindjes së Mesme, Kompleksi Aviacionit Civil Egjiptian, Cairo Airport Road, Heliopolis, Cairo 11776

Tel: (202) 267-4840; Faks: (202) 267- 4843; Sitatex: CAICAYA

Francë. Drejtor i Përgjithshëm i OACI, Zyra për Europën dhe Atlantikun Verior, 3 bis, villa Emille-Bergerat, 92522 Neuilly-sur-Seine (Cedex)

Tel: (331) 46 41 85 85; Faks: (331) 46 41 85 00; Sitatex: PAREUYA

India. Oxford Book and Stationery Co., Scindia House, New Delhi 110001 ose 17 Park Street, Calcutta 700016

Tel: (91 11) 331-5896; Faks: (91 11) 332-2639

Japoni. Fondacioni Japonez për Nxhtjen e Aviacionit Civil, 15-12, 1-chome, Toranomom, Minato-Ku, Tokyo

Tel: (813) 3503-1686; Faks; (813) 3503-2689



Kenia. Drejtor Rajonal i ICAO-s, Zyra e Afrikës Jugore dhe Lindore, Selia e Kombeve të Bashkuara, P.O. Box 46294, Nairobi

Tel: (254-2) 622-395; Faks (254-2) 226-706; Sitatex NBOCAYA

Meksikë. Drejtor Rajonal i ICAO-s, Oficina Nortreamérica, Centroamérica y Caribe, Masaryk No. 29-3er, piso, Col. Chapultepec Morales, México, D.F., 11570

Tel: (525) 250-3211; Faks: (525) 203-2757; Sitatex: MEXCAYA

Peru. Drejtor Rajonal i ICAO-s, Oficina Sudamérica, Apartado 4127. Lima 100

Tel: (51 14) 302260; Faks: (51 14)640393; Sitatex: LIMCAYA

Federata Ruse. Aviaizdat, 48, 1. Franko Street, Moscow 121351

Tel: (7 095) 417-0405; Faks: (7 095) 417-0245

Senegal. Drejtor Rajonal i ICAO-s, Bureau Afrique occidentale et centrale, Boite postale 2356, Dakar

Tel: (221) 8-23-54-52; Faks: (221) 8-23-69-26; Sitatex: DKRCAYA

Afrika e Jugut. Avex Air Training (Pty) Ltd., Private Bag X102, Halfway House, 1685, Republic of South Africa

Tel: (27-11)315-0003/4; Faks: (27-11) 805-3649; E-mail: avex@iafrica.com

Spanjë. A.E.N.A. – Aeropuertos Espanoles y Navegacion Aérea, Calle Juan Ignacio Luca de Tena, 14, Planta Tercera, Despacho 3.11, 28027 Madrid

Tel: (3491) 321-3148; Faks: (3491) 321-3157; Email: sscc.ventasoci@aena.es

Tajlandë. Drejtor i Përgjithshëm i ICAOs, Zyra për Azinë dhe Paqësorin, P.O. Box 11, Samayek Ladprao, Bangkok 10901

Tel: (66 2) 537-8189; Faks: (662) 537-8199; Sitatex: BKKCAYA

Mbretëri e Bashkuar. Westward Digital Limited, 37 Windsor Street, Cheltenham, Glos., GL52 2DG

Tel: (44 1242) 235-151; Faks: (44 1242) 584-139

PROTOKOLL

NË LIDHJE ME NJË AMENDAMENT TË KONVENTËS SË AVIACIONIT CIVIL NDËRKOMBËTAR, TË NËNSHKRUAR NË MONTREAL MË 10 MAJ 1984

Asambleja e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, mbledhur në seancën e 25-të (e jashtëzakonshme) në Montreal më 10 maj 1984,

duke vërejtur se aviacioni civil ndërkombëtar mund të ndihmojë fuqimisht në krijimin dhe ruajtjen e miqësisë dhe mirëkuptimit ndërmjet kombeve dhe popujve të botës, megjithëse abuzimi i tyre mund të shndërrohet në një kërcënim për sigurinë e përgjithshme;

duke vërejtur se është e përshtatshme që të shmangen mosmarrëveshjet dhe të nxitet bashkëpunimi midis kombeve dhe popujve nga të cilët varet paqja e botës;

duke vërejtur se është e nevojshme që aviacioni civil ndërkombëtar të zhvillohet në mënyrë të sigurt dhe të rregullt;

duke vërejtur se në përputhje me vëmendjen ndaj njerëzimit, duhet të garantohet siguria dhe jetët e njerëzve në bordin e avionit civil;

duke vërejtur se në Konventën e aviacionit civil ndërkombëtar të hartuar në Çikago më 7 dhjetor 1944, shtetet kontraktuese:

- njohën se çdo shtet ka sovranitet të plotë dhe ekskluziv mbi hapësirën ajrore të territorit të tij;

- në kuadrin e lëshimit të rregulloreve për avionët e tyre shtetërorë, garantojnë se do t'i kushtojnë vëmendjen e duhur sigurisë së navigimit të avionëve civilë; dhe

- bien dakord që të mos përdorin aviacionin civil për ndonjë qëllim në papajtueshmëri me qëllimet e Konventës;

Duke vërejtur vendimin e shteteve kontraktuese për të marrë masat e duhura të hartuara për të ndaluar shkeljen e hapësirës ajrore të shteteve të tjera dhe përdorimin e aviacionit civil për qëllime që janë në kundërshtim me objektivat e Konventës dhe për të rritur sigurinë e mëtejshme të aviacionit civil ndërkombëtar;

Duke vërejtur dëshirën e përgjithshme të shteteve kontraktuese për të rikonfirmuar parimin e mospërdorimit të armëve kundrejt avionëve civil në fluturim,



1. Vendos që për këtë arsye, është e përshtatshme të ndryshojë Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, të hartuar më 7 dhjetor 1944, në Çikago.

2. Miraton, në përputhje me ndryshimet e nenit 94 (a) të Konventës së lartpërmendur, amendamentet e mëposhtme të propozuara të Konventës.

Shton, pas nenit 3, një nen 3 të ri bis të:

“Neni 3 bis

a) Shtetet kontraktuese pranojnë që çdo shtet duhet t'u shmanget rasteve të përdorimit të armëve kundër avionëve civilë në fluturim dhe se, në rast interceptimi, jetët e personave në bord dhe siguria e avionit nuk duhet të vihen në rrezik. Kjo masë nuk duhet të interpretohet në asnjë mënyrë si ndryshim i të drejtave dhe detyrave të shteteve të përcaktuara në Statutin e Kombeve të Bashkuara.

b) Shtetet kontraktuese njohin që çdo shtet, në ushtrim të sovranitetit të tyre, ka të drejtë të kërkojë uljen në një aeroport të përcaktuar të një avioni civil që fluturon mbi territorin e tyre pa autorizim ose nëse ka arsye bindëse që të arrijë në përfundimin se është përdorur për ndonjë arsye në mospërputhje me objektivat e Konventës; gjithashtu mund t'i japë një avioni të tillë udhëzime të tjera që t'i japë fund një shkeljeje të tillë. Për këtë qëllim, shtetet kontraktuese mund të përdorin mënyrat e duhura në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë dispozitat përkatëse të kësaj Konvente, specifikisht paragrafi (a) i këtij neni. Çdo shtet kontraktues bie dakord të publikojë rregulloren e tij në fuqi për sa i përket interceptimit të avionëve civilë.

c) Çdo avion civil do të respektojë një urdhër të dhënë në përputhje me paragrafin (b) të këtij neni. Për këtë qëllim, çdo shtet kontraktues duhet të vendosë të gjitha dispozitat e nevojshme në rregullat dhe ligjet e tyre kombëtare për të bërë të detyrueshme pajtueshmërinë e çdo avioni civil të regjistruar në atë shtet ose që drejtohet nga një operator që ka qendrën e biznesit ose banim të përhershëm në atë shtet. Çdo shtet kontraktues duhet të dënojë çdo shkelje të një rregulli apo ligji në fuqi, me penaltete të ashpra dhe duhet t'ia paraqesë këtë rast autoriteteve të tij kompetente në përputhje me ligjet ose rregullat e tij.

d) Çdo shtet kontraktues do të marrë masat e duhura për të ndaluar përdorimin e paramenduar të ndonjë avioni civil të regjistruar në atë shtet ose që drejtohet nga një operator që ka qendrën e biznesit ose banim të përhershëm në atë shtet për ndonjë qëllim që është në mospërputhje me synimet e kësaj Konvente. Këto dispozita nuk do të ndikojnë në paragrafin (a) ose të derogojnë nga paragrafët (b) dhe (c) të këtij neni.”

3. Përcakton, sipas dispozitave të nenit 94(a) të Konventës së lartpërmendur, njëqind e dy si numrin e shteteve kontraktuese, pas ratifikimit të të cilëve amendamentet e lartpërmendura të propozuara do të hyjnë në fuqi, dhe

4. Vendos që Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil të hartojë një Protokoll në gjuhët angleze, franceze, ruse dhe spanjolle. Secili prej tyre duhet të jetë njëlloj autentik, duke reflektuar amendamentet e propozuara të sipërpërmendura dhe çështjet e mëposhtme:

a) Protokollin nënshkruhet nga Kryetari i Asamblesë dhe Sekretari i Përgjithshëm.

b) Protokollin do të jetë i hapur për ratifikimet nga çdo shtet, i cili ka ratifikuar ose aderuar në Konventën e sipërpërmendur mbi aviacionin civil ndërkombëtar.

c) Instrumentet e ratifikimit depozitohen në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

d) Protokollin do të hyjë në fuqi për shtetet të cilat e kanë ratifikuar në datën në të cilën janë depozituar 102 instrumentet e ratifikimit.

e) Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë menjëherë të gjitha shtetet kontraktuese në lidhje me datën e depozitimit të çdo ratifikimi të Protokollit.

f) Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha shtetet palë të Konventës së lartpërmendur në lidhje me datën në të cilën protokollin hyn në fuqi.

g) Për sa i përket çdo shteti kontraktues që ratifikon Protokollin pas datës së sipërpërmendur, Protokollin do të hyjë në fuqi pas depozitimit të instrumenteve të ratifikimit të tij pranë Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Si rrjedhojë, në përputhje me veprimet e lartpërmendura të Asamblesë,

Ky protokoll është hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës.



Në dëshmi të kësaj, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i seancës së 25-të (e jashtëzakonshme) të Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, të autorizuar nga Asambleja, nënshkruan këtë protokoll.

Hartuar në Montreal më 10 maj 1984 (një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër), në një dokument të vetëm në gjuhët angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, ku çdo tekst është njëloj autentik.

Ky protokoll do të mbetet i depozituar në arkivat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe kopjet e vërtetuara do të transmetohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës të të gjitha shtetet palë në Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, të hartuar më 7 dhjetor 1944 në Çikago.

Assad Kotaite

Yves Lambert

Kryetar i Seancës së 25-të (e jashtëzakonshme) të Asamblesë

Sekretar i përgjithshëm

**VENDIM
Nr. 76/2014**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 48/2013 “PËR
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputetja Adelina Rista caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 16.10.2014

DEKRET

Nr. 8756, datë 21.10.2014

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Dervish Muhamet Kapijaj
2. Majlinda Skënder Kapijaj (Muço)
3. Reis Dervish Kapijaj
4. Besnik Behar Bonaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

**VENDIM
Nr. 667, datë 8.10.2014**

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND EDHE PËR KANDIDATËT E
TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE
PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË
NË TND**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 27, pika 5, 29, pika 1, dhe 67, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, dhe në vijim të pikave 2, 3 dhe 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Përjashtimisht për vitin 2014, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND) është e hapur edhe për kandidatët e tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2014, pranimi në TND të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 83 veta.

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë për kandidatët nga jashtë shërbimit civil janë, si më poshtë vijon:

a) Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013;

b) Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” ose të barasvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione drejtuese ose të barasvlefshme me to, në:

- institucione të administratës publike;
- institucionet bankare të nivelit të dytë dhe që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh dhe që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij.

Përjashtimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë në institucione ndërkombëtare brenda vendit, në profesion jashtë vendit ose në profesione të rregulluara brenda ose jashtë vendit, duhet të kenë të paktën 5 (pesë) vite pune përkatësisht në këto institucione ose në profesion.

ç) Të mos jenë larguar nga puna si rezultat i shkeljeve të rënda apo të lehta, por të përsëritura;

d) Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Departamenti i Administratës Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 14, datë 9.10.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË
11.4.2014, “PËR PROCEDURAT DHE
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
FONDIT TË PROGRAMIT PËR
BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIT RURAL”
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 26.3.2014, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 4, datë 11.4.2014, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në skemën 1. Mbështetje për dorëzimin e prodhimit të frutave dhe perimeve në pikat e grumbullimit ose të përpunimit, në masën 15% të vlerës së mallit të shitur dhe të vërtetuar me faturë tatimore, por jo më pak se 30 (tridhjetë) kv dhe jo më shumë se 300 (treqind) kv, për frutat dhe për jo më pak se 50 (pesëdhjetë) kv dhe jo më shumë se 400 (katërqind) kv, për perimet, në pikën 1.3 “Procedurat që do të ndiqen”, shtohet germa “E” me këtë përmbajtje:

“E. Afati i dorëzimit të faturave

Afati i dorëzimit të faturave tatimore është data 1 nëntor 2014”.



2. Në skemën 19. Mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 7 (shtatë) vite radhazi, për kreditë deri në 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme, aktiviteti i parë riformulohet me këtë përmbajtje:

“Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, bimëve medicinale, si dhe mbarështimin e akuakulturës.”.

3. Në skemën 19 pika 3, “Procedurat që do të ndiqen” bëhen ndryshime dhe shtesa, si më poshtë:

a) Tek germa A “Aplikimi” pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Aplikimet për mbështetje financiare vetëm “Për mbarështimin e akuakulturës” paraqiten brenda 7 ditëve kalendarike, pas botimit të këtij udhëzimi në Fletoren Zyrtare.”.

b) Tek germa B, “Vlerësimi, paragrafi i shtatë dhe i tetë riformulohen me këtë përmbajtje: “Përfitues nga skema e subvencionit të normës së interesit mund të jenë aplikantë të kredituar gjatë vitit 2014, si dhe aplikantë të cilët kanë përfituar nga sistemi bankar 5 vitet e fundit, por që nuk kanë përfituar nga kjo skemë.”.

“Për aplikantët që do të përfitojnë gjatë vitit 2014, disbursimi i shumës së kredisë në favor të subjektit huamarrës, duhet të bëhet nga huadhënësi gjatë vitit 2014 dhe jo më vonë se periudha e 3-mujorit të parë të vitit pasardhës.”.

c) Tek germa C “Verifikimi dhe pagesa”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në fillim të paragrafit të parë shtohen fjalët “Për kredimarrësit e vitit 2014”.

- Pas paragrafit të pestë dhe të tetë shtohen paragrafët gjashtë dhe nëntë, me këtë përmbajtje:

“Për aplikantët përfitues të kredisë gjatë 5 viteve të fundit (përfshirë përfituesit e kredisë gjatë vitit 2014), do të bëhet verifikimi i investimit për përputhshmërinë me destinacionin e kredisë dhe biznesplanin e paraqitur.”.

“Kusht i domosdoshëm për subvencionin e normës së interesit është që subjekti të ketë paguar këstin e radhës së kredisë, sipas grafikut të pagesave.”.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE
Edmond Panariti

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

UDHËZIM
Nr. 15, datë 20.10.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË
UDHËZIMIN NR. 12, DATË 15.7.2014 “PËR
PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË
SIGURISË DHE CILËSISË SË MIELLIT
TË GRURIT TË PARAPAKETUAR, PËR
T’U SHITUR TEK KONSUMATORI I
FUNDIT OSE PËR PRODHIMIN E
PRODUKTEVE TË TJERA USHQIMORE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 15.7.2014 “Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t’u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”, në tabelën e shtojcës II “Kufiri i lejuar dhe metoda e analizimit për disa tregues të miellit të grurit” kufiri i lejuar për proteinën (Nx5,7) mbi bazën e peshës së thatë është 12.5% dhe bëhet 9%.

2. Dispozita e pikës 1 të këtij udhëzimi është e vlefshme deri në 1 janar 2015.

3. Ngarkohen Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

**URDHËR I PËRBASHKËT**

Nr. 8499, datë 17.10.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E DISA
RREGULLAVE TË QARKULLIMIT
RRUGOR NË ANSAMBLIN MONUMENT
KULTURE TË AKSIT KRYESOR DHE
QENDRËN HISTORIKE TË QYTETIT TË
TIRANËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7/1 të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

Ndalohet dhe kufizohet qarkullimi i automjeteve të të gjitha kategorive, si dhe parkimi i automjeteve në zonat e sheshit “Nënë Tereza” dhe Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, pjesë e Ansamblit Monument Kulture të aksit kryesor dhe Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Ndalohet qarkullimi i të gjitha kategorive të mjeteve të transportit në zonën përreth sheshit “Nënë Tereza” nga ora 19:00 deri në orën 24:00.

b) Qarkullimi i mjeteve do të kryhet si më poshtë:

- Qarkullimi i mjeteve nga rruga “Loro Borici” në drejtim të hotel “Sheraton” do të devijohet me sens lëvizjeje nga rruga “Lek Dukagjini” në drejtim të Sheshit “Italia”.

- Qarkullimi i mjeteve nga sheshi “Frederik Shopen” do të devijohet me sens lëvizjeje në rrugën “Ibrahim Rugova”.

- Qarkullimi i mjeteve nga rruga “Abdyl Frashëri” me drejtim lëvizje drejt bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, në kryqëzimin me bulevardin “Dëshmorët e Kombit” do të jetë detyrimisht majtas me drejtim urën e madhe të Lanës.

2. Ndalohet pushimi dhe qëndrimi i të gjitha kategorive të mjeteve të transportit rrugor në zonën përreth sheshit “Nënë Tereza”, me përjashtim të mjeteve të transportit publik të linjave urbane (autobus).

3. Ndalohet pushimi dhe qëndrimi i të gjitha kategorive të mjeteve të transportit rrugor duke filluar nga sheshi “Nënë Tereza” përgjatë bulevardit “Dëshmorët e Kombit” deri te ura e madhe e Lanës në kryqëzimin me bulevardin “Bajram Curri”, me përjashtim të mjeteve të transportit publik të linjave urbane (autobus).

4. Bashkia e Tiranës pajis me sinjalistikë rrugore të nevojshme, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij urdhri dhe bën ndërhyrjet e nevojshme në sistemin semaforik për të përshtatur sinjalistikën ekzistuese sipas ndryshimeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Saimir Tahiri

MINISTRI I KULTURËS

Mirela Kumbaro Furxhi

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE

INFRASTRUKTURËS

Edmond Haxhinasto

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 36 lekë